

KONTRATË DHURIMI

Sot më 21/11/2019 ortakët i vetëm shoqëria “CFO Pharma” sh.p.k. me NIPT K22305002U me adresë: Rruga Pavarësia Ndërtesa Nr. 1 Mëzes, Kashar, Tiranë, përfaqësuar nga ortaku i vetëm **Z. Nadir Çausholli**, lindur në Tiranë më 14.02.1978 me Nr. Personal H80214054U dhe **Znj. Arjola Çausholli** lindur në Kamëz më 14.05.1986 me Nr. Personal I65514098G. Të dy palët si dhuruesi dhe pranuesi janë dakord me dhurimin e kuotave.

Palët janë:

Pala Dhuruese: “CFO Pharma” sh.p.k përfaqësuar nga ortaku i vetëm **Z. Nadir Çausholli**, lindur në Tiranë më 14.02.1978 me Nr. Personal H80214054U.

Pala Pranuese: Znj. Arjola Çausholli, lindur në Kamëz me 14.05.1986 me Nr. Personal I65514098G.

Neni 1: Objekti kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhurimin e pjesëmarrjes në përqindje 100% të “CFO Pharma” sh.p.k që zotëron tek kompania “Albadent Group” sh.p.k, për tek Znj. Arjola Çausholli.

Neni 2: Vlera e Dhurimit

Palët bien dakord që vlera e dhurimit të 100% të pjesëmarrjes në përqindje që “CFO Pharma” sh.p.k e përfaqësuar nga ortaku i vetëm **Z. Nadir Çausholli**, ka tek kompania “Albadent Group” sh.p.k. është ajo në vlerën **15. 000. 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë**. Këto kuota do i dhurohen **Znj. Arjola Çausholli**. Palët nuk kanë asnjë pretendim kundrejt njëri-tjetrit, përsa i përket këtij neni.

Neni 3: Kalimi i pronësisë

Hyrja në fuqi e kontrates do te realizohet kur nënshkruhet nga palët. Ekzekutimi i veprimeve për kalimin e plotë të pronësisë do të realizohet pranë Q.K.B.

Neni 4: Të drejtat dhe detyrimet e Dhuruesit



Dhuruesi merr përsipër, garanton dhe siguron pranuesin se deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe të nënshkrimit të Kontratës, kuotat e mësipërme janë:

1. Të lira nga cdo lloj barre dhe pengu;
2. Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
3. Nuk ka persona të tretë që të kenë pretendime në lidhje me pronësinë mbi këto kuota.

Pranuesi është i detyruar të paguaje tatimin mbi të ardhurat nga dhurimi, në qoftë se do të ketë, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Neni 5: Të drejtat dhe detyrimet e Pranuesit

Ai ka të drejtë të gëzojë i qetë kuotat nga **Dhuruesi** dhe në rast të kundërt, të kërkojë nga ky i fundit të zgjidhe konfliktin që mund të vijë nga të tretët, për probleme të lindura përpara datës së dhurimit të kuotave.

Neni 6: Interpretimi i kontratës në tërësi

Çdo kusht apo formulim që mund të jelle paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyn palët të lidhin këtë kontratë.

Neni 7: Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni .

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

DHURUESI

CFO Pharma sh.p.k

Ortaku i vetëm

Nadir Çausholli

Nadir Çausholli
Arjola Çausholli



PRANUESI

Arjola Çausholli

Arjola Çausholli